



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:135063
Datë: 09.01.2025
Numri i dokumentit: 06689566
C.nr.90/2018

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka si gjyqtar individual me Sekretaren Juridike Azemine Berisha, në çështjen civile- juridiko të paditësit N.L, nga fshati ..., me numër personal ..., me vendbanim në Rrugën, PN, Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ma. sc. Sh.F, avokat me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson B.Z, avokate shtetërore, për çështjen kontestuese Anulimin e vendimeve të Komisionit të Brendshëm Disiplinor me numër 110/KBD/23, i datës 17.03.2023 dhe vendimi i Komisionit për Ankesa i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me numër reference 199-KA-2023, i datës 18.05.2023, kthimin në vendin e punës dhe pagesën e të ardhurave personale, vlera e kontestit 11,854.33€, në seancën kryesore të mbajtur më datën 24/12/2024, në praninë e paditësit dhe të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datën 09/01/2025, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tersi si e bazuar, kërkesë padia e paditësit N.L, nga fshati ..., me vendbanim në Rrugën ..., PN, Ferizaj dhe ANULOHEN vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor (KBD), i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me numër reference 110/KBD/23, i datës 17.03.2023 dhe vendimi i Komisionit për Ankesa i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me numër reference 199-KA-2023, i datës 18.05.2023, me të cilat paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe refuzuar ankesa, si të kundër ligjshëm-jo ligjore.

II.DETYROHET, e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme, me seli në Prishtinë, qe paditësin N.L, me vendbanim në Ferizaj, ta kthej ne vendin e punës, ku ka punuar me parë, në Stacionin Policor Kufitar Gllloboqicë DRP-Lindje, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëdhënia e punës, i cili kthim do te behet ne afat prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi .

III. DETYROHET, e paditura qe paditësit, te ja paguaj shumën prej 11,854.33 €, edhe atë: në emër të pagave të pa paguar, për periudhën kohore 25.05.2023, e deri më datën 31.08.2024 (data e përpilimit të ekspertizës), shumën prej 9,854,33€, ndërsa shumën prej 1,103,46€,(ne emër te vlerës për kontributet e pension për punëdhënësin dhe punëmarrësin), shumen prej 628.46€, (ne emër se tatimit ne pagë).

Ndërsa për periudhën e ardhshme, pas përpilimit të ekspertizës financiare, nga data 01.09.2024, të i,a paguaj pagat, të cilat do të bëhen të kërkueshme, deri në kthimin në vendin e punës, me kamat prej 8 %, të cilat do të llogariten, nga dita e arritjes së secilës kërkesë për pagës veç e veç, duke filluar nga data 24.12.2024 (data e seancës kryesore), e deri në pagesën përfundimtare.

IV. DETYROHET pala paditëse, qe ta paguaj shumën prej 100.00€, në emër të taksës për padi, e cila pagës do të bëhet në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit

V. DETYROHET e paditura, që paditësit te ja paguaj shumen si ne piken III, të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shume prej 935.00 €, e cilat pagesa do te bëhen ne afat prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi, për mes të autorizuarit, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme, me seli në Prishtinë. Me këtë padi ka kërkuar Anulimin e vendimeve të Komisionit të Brendshëm Disiplinore (KBD), i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me numër reference 110/KBD/'23, i datës 17.03.2023 dhe vendimi i Komisionit për Ankesa i Drejtorisë se

Përgjithshme te Policisë së Kosovës me numër reference 199-KA-2023, i datës 18.05.2023, kthimin ne vendin e punës ku ka punuar me parë, në Stacionin Policor Kufitar Gllloboqicë DRP-Lindje .

Po ashtu ka kërkuar pagesën e të ardhurave personale, në shumë prej 9,854.33 €, në emër të pagave të pa paguar, për periudhën kohore 25.05.2023, e deri më datën 31.08.2024 (data e përpilimit të ekspertizës), ndërsa shumën prej 1,103,46€, (ne emër te vlerës për kontributet e pension për punëdhënësin dhe punëmarrësin), shumen prej 628.46€, (ne emër se tatimit ne pagë), sepse kërkesa e padisë është e bazuar.

Këto kërkesa janë të bazuara, për fakti se ekziston baza e kërkesës, e cila mbështetet në faktet siç janë parashtruara në padi, janë të mbështetur në Ligjin për Policinë, Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2019, për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në policinë e Kosovës. E paditura në këtë çështje juridiko kontestimore, gjithë hetimin e saj dhe vendimet e marra ndaj tani paditësit për Ndërprerjen e Marrëdhënies së punës, nga Policia e Kosovës, i ka marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore, për faktin se në asnjë moment dhe në asnjërën nga pjesët e arsyetimit të vendimit, nuk ka arritur të dëshmojë se paditësi N.L, ka kryer dhe është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 20-Sjellja e rëndë diskredituese, pika 1.14 dhe pika 1.8, neni 23-Korrupsioni dhe konflikti i interesit, nenin 24-Shkelja e rëndë e autorizimit pika 1.4 dhe pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019.

Nga provat (përgjimet), DHBVK-ja, e as KBD-ja, nuk kanë arritur që ti argumentojnë shkeljet, për të cilat e kanë shpallur përgjegjës Paditësin, për faktin se me asnjërën nga provat, nuk është argumentuar se Paditësi me veprimet dhe sjelljet e tij ,mund ta ketë dëmtuar imazhin e Policisë së Kosovës gjatë kryerjes së detyrës apo jashtë saj.

Po ashtu e Paditura, nuk ka arritur të dëshmojë, se tani këtu Paditësi, në këtë çështje Civile-juridike ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar në njërin nga paragrafët e nenit 23-Korrupsioni dhe konflikti i interesit, për faktin se nuk është arritur të dëshmohet me asnjë provë të vetme se Paditësi N.L, e ka keqpërdorur pozitën e tij si punonjës i Policisë së Kosovës, për leverdi private për vete ose për të tjerët.

Po ashtu nuk është arritur të dëshmohet, se ka kryer ndonjërin nga shkeljet e rënda disiplinore, të përcaktuara në nenin 24-Shkelja e rëndë e autorizimit, për arsye se në këtë çështje

juridiko kontestimore, nuk është arritur të argumentohet, se cilën veprë penale apo informacion të rëndësishëm, për zbulimin e veprave penale apo kryerësve të tyre, tani këtu paditësi nuk i ka raportuar tek mbikëqyrësit e tij.

Pasi që në këtë rast e Paditura të përmbushte kompetencat e saj, do të dëshmohej e kundërta, pasi Paditësi, shumë herë ka siguruar informacione për vetë Sh.L, e po ashtu ka siguruar edhe shumë informacione nga vetë Sh.L për aktivitete kriminale në zonën e Kaçanikut dhe më gjerë, e të cilat i ka shpërndarë në sektor, njësi dhe drejtori të caktuara të Policisë së Kosovës.

E Paditura, në vendimet e saj të atakuar, me këtë padi dhe propozim, ka dështuar të vërtetojë faktet, se në cilën rrethanë paditësi ka kryer shkelje të nenit 24, pika 1.6 të U.A 04/2019, për faktin se në asnjë rrethanë nuk është arritur të argumentohet se në çfarë mënyrë, kur, si, pse, me kënd, Paditësi ka keqpërdor autoritetin e Policisë, cili ka qenë përfitimi personal apo financiar, apo se çfarë përfitime e privilegje i ka përfituar, e të cilat nuk mund t'i kenë në dispozicion, përveç kur kryejnë detyrat e tyre ose për shmangie nga pasojat e veprave kundërligjore, përveç në ato raste kur kërkohet prej tyre në mënyrë legjitime ta përdorin ndikimin apo autoritetin e tyre.

Pra në këtë çështje, nuk kemi një aktgjykim nga Gjykata kompetente, me të cilën i padituri është shpallur fajtorë dhe për pasojë besueshmëria dhe arsyetimi i vendimeve të atakuar me këtë padi, vetëm në provat që janë siguruar gjatë procedurës penale, në një rast tjetër penal, ndaj personave të tjerë bie në kundërshtim me nenin 4 par. 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2019 ku përcaktohet se “Procedura disiplinore zhvillohet e pavarur nga procedura penale apo ndonjë procedurë tjetër kundërvajtës, me përjashtim të rasteve kur zhvillimi i procedurës disiplinore varet ekskluzivisht nga provat që janë duke u administruar në procedurën penale apo vendimi i gjykatës. Nga provat e siguruara në procedurë penale, në një çështje tjetër penale ndaj personave të tjerë, janë përdorur edhe në procedurën penale me numër PP/I. nr. 216/21, ndaj Paditësit N.L, e për të cilën përkundër pretendimeve të Paditurës.

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, lidhur me hetimet penale të filluara ndaj tani këtu Paditësit, në çështjen penale PP/I.nr. 216/22, me datë 22.04.2024, në pajtim me nenin 156 par. 1 nën par. 1.1 të KPP-së, ka nxjerrë Aktvendim, me të cilin ka PUSHUAR HETIMET, ndaj tani këtu Paditësit N.L, pasi që nga provat të cilat janë gjendur në shkresat e lëndës si dhe ato të mbledhura gjatë fazës së hetimeve, nuk është vërtetuar dyshimi i

arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprën penale në drejtim të së cilës janë filluar hetimet, e as të ndonjë veprë tjetër penale, e cila ndiçet sipas detyrës zyrtare.

Vendimet e atakuar me këtë padi, konkretisht arsyetimi i të njëjtëve, në asnjë pjesë të tyre nuk paraqet asnjë prej pretendimeve të ngritura në ankesë, po ashtu nuk referon bazuar në prova dhe duke argumentuar se pse ndonjëri nga pretendimet nuk është i pranueshëm për organin e paditur, e që një arsyetim i tillë duke mos argumentuar pretendimet që i pranon si të bazuar apo duke argumentuar të njëjtat si të pa bazuara, e bën vendimin të kundërligjshëm dhe i cili nuk përmban elemente të aktit administrativ.

Po ashtu e paditura, vetëm liston provat duke mos arsyetuar, se cilat nga to ishin të pranueshme dhe cilat nga ato janë të pa pranueshme, për organin e paditur dhe cilat janë ato prova vendimtare, në të cilat mbështete e paditura.

E njëjta thekson se ka analizuar provat veç e veç, duke mos cekur, cilat janë ato prova të vlerësuara me të cilat ka vërtetuar se Paditësi ka kryer shkeljet e rënda mbi bazën e të cilave edhe janë marrë vendimet e atakuar me këtë padi. E paditura referohet po ashtu në nenin 88 të LPPA-së, me pretendimin në fakte të njohura për organin publik duke anashkalluar se faktet duhet të provohen me prova e të cilat prova mjaftueshëm janë argumentuar nga këtu Paditësi, se të njëjtat janë marrë në kundërshtim me ligjin, janë përdorur në mënyrë të kundërligjshme dhe të njëjtat mund të atakohen pranë Gjykatave të rregullta dhe si të tilla, në këtë fazë nuk paraqesin provim të fakteve të pretenduara.

Prandaj referimi në një dispozitë të tillë, duke i ikur përgjegjësisë (duke shkelur po ashtu dispozitat nga neni 4 par. 4 të UA nr. 04/2019) të Paditurës që të provojë argumentet e saj, fillimisht e bënë organin e paditur jo serioz, diskriminues e për pasojë ka nxjerrjen e një vendimi të kundërligjshëm dhe të pa mbështetur në prova, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore duke pasur në vëmendje po ashtu elementet që duhet ti përmbajë akti administrativ.

E paditura parafrazon “në përgjithësi pretendimet ankimore”-si jo relevante lidhur me çështjen, duke mos arsyetuar fare fillimisht, cilat janë ato pretendime ankimore, e po ashtu duke mos arsyetuar, se pse të njëjtat janë jo relevante, lidhur me çështjen, duke mos arsyetuar se cili është ai tentim për ikje nga përgjegjësia disiplinore nga paditësi, i cili shfrytëzon një të drejtë që ligji ja njeh, për ti prezantuar provat, argumentet, pretendimet, me qëllim të vërtetimit se

vendimet e të paditurës janë të kundërligjshme dhe ja shkelin një të drejtë elementare siç është ajo e punësimit (Pa mundësimin të ushtrimit të profesionit).

Po ashtu vendimi i atakuar me këtë Padi, nuk përmban asnjë bazë-referim ligjor, dhe arsyetimin, se pse kjo bazë ligjore është e aplikueshme në këtë çështje. Është shqetësuese fakti se tani këtu e paditura, me një vendim administrativ, me të cilin cenohet një e drejtë elementare e njeriut, e drejtë kushtetuese siç është ajo e Të drejtës së punës-ushtrimit të profesionit, pa u mbështetur në asnjë bazë ligjore, duke dështuar të arsyetojë aplikimin e një dispozitë përkatëse ligjore dhe arsyen se pse aplikohet në rastin konkret.

Theksojmë se vendimet e atakuar me këtë padi, nga ajo që është elaboruar thuajse nuk përmbajnë fare arsyetim mbi bazën se edhe arsyetimi i pretenduar-parafrazuar është i paqartë, nuk ka arsyetim, se cilat fakte janë marrë parasysh, me rastin kur është marrë vendimi, që ndaj Paditësit ti shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Një arsyetim i tillë, i pa qartë, i pa mjaftueshëm, dhe i pa bazuar në prova, bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 48, paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e ku është përcaktuar se arsyetimi duhet të përmbajë 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

Prandaj si pasojë e mungesës së një arsyetimi të mjaftueshëm, të qartë, të kuptueshëm dhe i bazuar në prova konkrete materiale është i barabartë me mungesën e tij, gjë e cila sipas dispozitës së nenit 52, par. 1, vendimin e atakuar, me këtë ankesë, e bënë të paligjshëm, e si i tillë është edhe i pavlefshëm, po ashtu një veprim i tillë bie ndesh edhe me dispozitën e nenit 5 par. 24 të UA nr. 04/2019 ku përcaktohet se *“Para se të merret vendim për shqiptimin e masës disiplinore, autoriteti vendimmarrës ka detyrim që t’i identifikojë, t’i verifikojë dhe t’i shqyrtojë me ndershmëri dhe në tërësi faktet e rëndësishme”*.

Po ashtu vendimet e të paditurës, si vendimi i KBD-së dhe i KA-së, i atakuar me këtë padi, janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 10 par. 3 të UA Nr. 04/2019, për faktin se as

autoriteti hetues, e as autoriteti vendimmarrës në këtë rast, gjatë procesit të rekomandimit dhe vendimmarrjes, në procesin disiplinor, nuk kanë marrë për bazë rrethanat lehtësuese të kryerjes së shkeljes disiplinore të pretenduar, peshën si dhe natyrën e shkeljes për rekomandimin e masës disiplinore, për caktimin e masës disiplinore, brenda kufijve të paraparë për shkelje përkatëse disiplinore, por kanë marrë parasysh vetëm rrethanat rënduese.

Po ashtu dosjes disiplinore të lëndës, me numër 0543-PK-2022 dhe IPK/DH/99/22/VP i kanë bashkangjitur edhe vërtetimin mbi verifikimin në bazën e të dhënave në DHBV, për hetime të brendshme, për periudhën e verifikimit 2010-2022, e ku rezulton se paditësi në këtë vërtetim i është vendosur edhe lënda me numër 096-PK-2017, me akuzë veprimtari penale që figuron si rast i mbyllur, e për të cilin rast i është shqiptuar masa Ndalesë në pagë 25 %, e pagës mujore bruto për 2 muaj, e që ky rast nuk ka të bëjë me paditësin N.L por është rast që i takon zyrtarit tjetër policor me emrin N.L, i cili më herët kishte punuar në vijë të gjelbër, e i cili është djali i axhës së personit Sh.L, e që një fakt i tillë është dashur të vërtetohet para se këtu paditësi ti vështirësohet pozicioni në procedurën administrative disiplinore, si person që edhe më here, gjoja se ka kryer shkelje të rënda disiplinore dhe ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinor, gjë e cila nuk qëndron dhe se konstatimin e tillë të KBD-së, Komisioni i Ankesave, nuk e ka trajtuar fare dhe një gjë të tillë e ka pranuar.

Po ashtu e paditura, përmes organeve të saj si KBD e as DHBVK, nuk kanë marre për bazë rrethanën tjetër lehtësuese, për faktin se ankuesi N.L, në vazhdimësi informacionet që i ka pranuar dhe siguruar nga personi Sh.L, i ka bartur tek Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotik, gjë të cilën fare lehtë edhe DHBVK por edhe KBD, ka pasur mundësi ta verifikojnë, vërtetësinë e pretendimit të ankuesi duke vendosur kontakt me Majorin R.M, me pozitë Drejtor i DHTN-së apo edhe Shefin e Njësisë së DHTN-së në Ferizaj Togerin I.B, e ku rezulton se nga informacioni i siguruar nga ankuesi përmes personit Sh.L, ka rezultuar me operacione të suksesshme të Policisë së Kosovës në fushën e luftës kundër narko-kriminalitetit.

E paditura, me vendimet e saj të atakuar me padi, ka shkelur edhe dispozitën ligjore nga neni 4 par. 1 nënë par. 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-021, për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku përcaktohet se “1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji” dhe “1.2. Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo

praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme”.

Nga veprimet e të Paditurës, e ka akceptuar në raste të ndryshme, duke mos ju shqiptuar zyrtarëve policor të tjerë masën “Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës” edhe kur janë dënuar për vepra penale, kundër detyrës zyrtare apo vepra të tjera penale, e që ju ishte shqiptuar dënim me burgim 6 muaj apo me gjobë, ndërsa në rastin e Paditësi gabimisht kanë zbatuar dispozitat materiale dhe Paditësit edhe pse nuk është dënuar por përkundrazi Prokuroria ka pushuar hetimin ndaj tij e paditura, në mënyrë të kundërligjshme i shqipton masën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e që kjo bie ndesh me Ligjin nr. 03/L-212, i Punës konkretisht dispozitën e nenit 5, par 1ku përcaktohet se: “ Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi ”.

Përkundër, që në kuptim të nenit 20 par. 2, ku përcaktohet, se Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, Gjykatës i vëmë në dijeni se për raste të ngjashme –situata të krahasueshme, siç janë rastet F.R, M.M VS Policia e Kosovës, ku zyrtarët policor, janë dënuar për vepra penale, të kapitullit të korrupsionit dhe ndaj të njëjtave, e Paditura nuk ka shqiptuar masën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, por ka shqiptuar masa më të lehta disiplinore, pastaj rastin e zyrtarit tjetër Policor Z.S VS Policisë së Kosovës, përkundër që Gjykata Themelore në Prizren, i kishte shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 muajve me kusht, të njëjtit organi, i paditur nuk i ka shqiptuar masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës, por i ka shqiptuar masë më të lehtë disiplinore.

Po ashtu ka edhe shumë raste të tjera kur punonjës të policisë, kanë aktakuza të ngritura dhe organi i paditur, i pezullon procedurën deri në vendimin e plotfuqishëm gjyqësor si rasti M.G etj., VS Policia e Kosovës, apo A.D dhe V.M VS Policisë së Kosovës, kurse ndaj tani këtu Paditësit përkundër se i njëjti nuk ka procedurë të hapur dhe procedura penale, e iniciuar është

hedhur poshtë me aktvendim të Prokurorisë, organi i paditur e trajton në mënyrë diskriminuese, duke ja ndërprerë marrëdhënien e punës.

Lidhur me këto referime, të cilat i shërbejnë Gjykatës si prova, e të cilat janë të qasshme për Gjykatën, qoftë si të publikuara në media apo ueb sajtin e Gjykatave përkatëse dhe në rastin konkret është propozuar nga Paditësi që e Paditura të ja dorëzojë Gjykatës në kuptim të dispozitave ligjore të LPK-së dhe LPPA-së, e që me të njëjtat qartë do të dëshmohej se tani këtu e Paditura ka diskriminuara Paditësin, ka përdor standarde të dyfishta në raport me këtu paditësin, mirëpo përkundër që në kuptim të nenit 20 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku përcaktohet se *Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë*, e Paditura nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të kundër argumentuar pretendimet e paditësit e që në fakt edhe në shqyrtimin kryesorë të mbajtur me datë 24.12.2024, paditësit e ka njoftuar Gjykatën se duke marr për bazë praktiken gjyqësore në raste të ngjashme.

Gjykata është njoftuar edhe në seancën e shqyrtimit kryesorë, të mbajtur me datë 24.12.2024, që në rastin me numër C.nr. 863/22, çështja H.K VS Policia e Kosovës, Gjykata Themelore në Gjakovë- Dega Malishevë, kishte anuluar vendimet e tani këtu të paditurës dhe të njëjtin e kishte kthyer në vendin e punës si Zyrtar policor edhe pse gjatë asaj procedure ishte vërtetuar se paditësi në atë çështje në procedure penale kishte pranuar fajësinë për veprë penale me ç ‘rast Gjykata e kishte shpallur fajtor duke i shqiptuar sanksion penal, ndërsa përsëri këtë aktgjykim edhe Gjykata e Apelit e kishte vërtetuar me aktgjykim numër AC. Nr. 5767/23.

Prandaj në rastin e këtu paditësit N.L edhe pse ndaj të njëjtit është pushuar hetimi dhe për të njëjtin nuk kemi një vendim se është fajtor për veprë penale, përsëri e paditura i ka ndërpre marrëdhënien e punës në mënyrë të kundërligjshme.

Raste të tilla të ngjashme, kur zyrtarët policor janë dënuar për veprë penale, e nuk ju është ndërprerë marrëdhënia e punës nga e paditura ka shume (e që disa veç janë theksuar në padi dhe deklaratimet e gjertanishme), ndërsa raste kur zyrtar policor nuk janë shpallur fajtor për veprë penale, e as nuk ju është ngritur aktakuzë, ndërsa në shkelje të udhëzimit administrativ, provat e siguruara gjatë hetimit penal, janë përdorur në çështje disiplinore pa një vendim të gjykatës është vetëm rasti i paditësit N.L, e që kjo paraqet diskriminim të hapur, trajtim ndryshe nga të tjerët, gjithnjë në dëm të paditësit nga ana e të paditurës.

Paditësit, si rezultat i veprimeve të kundërligjshme të Paditurës, i është shkaktuar dëm shumë i madhe, i cili është vërtetuar edhe me ekspertizën financiare, për të cilën asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ka pasur pyetje apo vërejtje.

Sa i përket përgjigjes në padi dhe deklarimeve të gjertanishme, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridiko kontestimore të paditurës, të njëjtat i kundërshtojmë, për faktin se janë boshe, të pa mbështetura në prova dhe argumente, duke parafrazuar vetëm vendimet e saj, por të njëjtat duke mos i bazuar në asnjë provë apo dispozitë ligjore, se cila ishte baza juridike dhe faktike kur e njëjta gjatë procedurës ka nxjerrë vendimet e kundërligjshme e që janë atakuar me këtë padi, prandaj të njëjtat janë të pa bazuara në tërësi

Shpenzimet i ka kërkuar

E paditura si në përgjigje në padi, ashtu edhe gjatë seancave të mbajtura, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj në tërësi si të pa bazuara dhe të mbeten në fuqi vendimet e të paditurës edhe atë: vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor, me numër 310/KBD/20, i datës 17.03.2023 dhe Vendimin e Komisionit të Ankesave, i Policisë së Kosovës, me numër 199-KA-2023, me të cilat paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, sepse këto vendime janë të ligjshme.

E paditura, i ka kundërshtuar pretendimet e palës paditëse, se marrëdhënia e punës i është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme, sepse këto pretendime nuk janë vërtetuar pasi që paditësi ka kryer shkelje të rëndë disiplinore, mbi bazën e së cilës punëdhënësi ka ngritur procedurën e rregullt disiplinore dhe i ka shqiptuar masën adekuate të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Tutje ka theksuar se vendimi i komisionit disiplinor, i datës 17.03.2023, është në përputhje të plotë me rregulloren mbi procedurën disiplinore të Policisë së Kosovës, në kohën kur ka ndodhur shkelja dhe se pretendimet e palës paditëse në këtë rast janë të pa bazuara.

Tutje ka theksuar se komisioni për ankesa, tani paditësit ja ka refuzuar ankesën, sepse me asnjë provë nuk e ka vërtetuar pretendimin e vetë dhe nuk ka mundur ta vërtetoj një gjendje tjetre faktike. Vendimi i atakuar i komisionit disiplinor është i qartë, i kuptueshëm, i arsyetuar për masën e shqiptuar ndërprerje e mardhenjës së punës.

Po ashtu ka theksuar, se të gjitha provat, flasin në drejtim të asaj se është e vërtetë që në këtë çështje ka përfunduar procedura penale, me Aktvendimin e datës 22,04,2024, ndaj tani paditësit, kanë pushuar hetimet për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 të KPRK-së , sepse nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale.

Është e vërtet se procedura penale ka përfunduar, me aktvendimin për pushimin e hetimeve, por në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi civile gjegjësisht disiplinore, për të cilën drejtë është vendosur nga e paditura-punëdhënësi.

Nga provat e administruara, është vërtetuar se paditësi, me vendimin e komisionit të brendshëm disiplinor nr.110/KBD/2023, i datës 17.03.2023, me detyrë në Stacionin Policor Kufitar Gilloboqicë DRPK Lindje, është përgjegjës, për shkak të shkeljeve nga kapitulli III neni 20 sjellja e rëndë diskredituse pika 1.14 dhe pika 1.8 , nenit 23 Korrupsioni dhe konflikti i interesit dhe neni 24- shkelja e rëndë e autorizimit, pika 1,4 dhe pika 1,6 të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore, në Policin e Kosovë

Po ashtu ka theksuar, se të gjitha provat, flasin në drejtim të asaj se është e vërtetë që në këtë çështje ka përfunduar procedura penale, me Aktvendimin e datës 22,04,2024, ndaj tani paditësit, kanë pushuar hetimet për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 të KPRK-së , sepse nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale.

. Prandaj nga këto baza i ka propozuar gjykatës, qe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tersi si të pa bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar në mënyrë të drejtë ne këtë çështje kontestimore të kompensimit të dëmit, gjykata bëri administrimin e këtyre provave të shkruara duke bërë leximin e këtyre provave: U lexuan provat: Vendimi i datës 18.05.2023, Ankesa e datës 20.04.2023, Vërtetimi mbi pranimin e ankesës , Vendimi i datës 17.03.2023, Ankesa e datës 19.04.2023, Raporti përfundimtar i hetimeve, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit, Përgjigja në propozim, Përgjigja në padi, Aktgjykimi PKR.nr.82/19, Aktvendimi i datës 06.10.2023, Ankesa e datës 01.11.2023,

Aktvendimi AC.nr.7738/23, Aktvendimi i datës 22.04.2024, Deklarimi për seancë , Ekspertiza financiare , pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës prove veç e veç dhe të gjithave bashkërisht, e në bazë të dispozitave të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatë, kjo gjykatë për këtë çështje kontestimore, vërtetoi këtë gjendje këtë gjendje faktike:

Paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura, në detyrë në Stacionin Policor Kufitar Gllloboqicë DRPK Lindje. Marrëdhënia e punës, ju ka ndërprerë me datën 17.03.2023, kinse ka bere shkelje te rëndë disiplinore, te parashikuara në kapitulli III neni 20 sjellja e rëndë diskredituse pika 1.14 dhe pika 1.8 , nenit 23 Korrupsioni dhe konflikti i interesit dhe neni 24-shkelja e rëndë e autorizimit, pika 1,4 dhe pika 1,6 të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore, në Policin e Kosovës. E paditura, paditësit ja ka shqiptuar masën ma të rëndë disiplinore dhe nuk ja ka shqiptuar masën konform shkeljes së bërë. Paditësi është liruar nga përgjegjësia penale. E paditura nga veprimet e paditësit nuk ka pësuar damë, ndërsa paditësi për shkak të veprimeve të paditurës ka pësuar damë në vlerë prej 11,854.33,€.

a) Se paditësi N.L , ka gene ne marrëdhënie pune tek e paditura, në Stacionin Policor Kufitar Gllloboqicë DRPK Lindje, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga thëniet në padi, raportin përfundimtar, vendimin e datës 17.03.2023, ku në pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi, është shënuar, se tani paditësi, punonjës i policisë është i punësuar në policinë e Kosovës në detyrën në Stacionin Policor Kufitar Gllloboqicë DRPK Lindje, i cili fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

b) E paditura, paditësit marrëdhënien e punës, ja ka ndërprere me datën 17.03.2023, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor, numër i lëndës: 110/KDB/2023, i datës 17.03.2023, ku është shënuar se tani paditësit N.L, i ndër -prehet marrëdhënia e Punës, për shkak të shkeljeve disiplinore nga kapitulli III neni 20 sjellja e rëndë diskredituese pika 1.14 dhe pika 1.8 , nenit 23 Korrupsioni dhe konflikti i interesit dhe neni 24-shkelja e rëndë e autorizimit, pika 1,4 dhe pika 1,6 të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore, në Policin e Kosovës.

c) e paditura, paditësit nuk ja shqiptuar, masën disiplinore, konform shkeljes së bërë, por ja ka shqiptuar masën ma të rëndë disiplinore, ndërprerja e mardhenjës së punës. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga vendimi 17.03.2023, paditësit i është shqiptuar masa ma e rëndë disiplinore ndërprerja e mardhenjës së punës. Nga raporti përfundimtar i hetuesit Ref.0543-359-PK-20122 IPK/DH/99/22/VP, është konstatuar, se tani paditësi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, te parashikuara në kapitulli III neni 20 sjellja e rëndë diskredituse pika 1.14 dhe pika 1.8 , neni 23 Korrupsioni dhe konflikti i interesit dhe neni 24- shkelja e rëndë e autorizimit, pika 1,4 dhe pika 1,6 të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore, në Policin e Kosovës.

Neni 41 të Udhëzimi Administrativ Nr.04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore në Policinë e Kosovës, janë paraparë Masat për shkelje të rënda disiplinore për punonjësit e PK-së , edhe atë siç vijon 1. Masat që mund të merren ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore janë: 1.1. ndërprerja e marrëdhënies së punës, 1.2. degradim - jo më shumë se një gradë 1.3. largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi me të ultë menaxhuese, por pa e humbur gradën dhe kategorinë funksionale. 1.4. ndalesën në pagë mbi 20% deri ne 30%, e pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj. 2. Krahas masave të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohen edhe masat plotësuese:2.1.Transfer administrativ;2.2. Trajnim obligativ;2.3. Këshillim mjekësor/psikologjik dhe 2.4. Ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri në 1 vit. Pra kanë ekzistuar disa masa tjera qe i përgjigjen shkeljes, në rastin konkret.

E paditura, me rastin e vendosjes, paditësit ja ka shqiptuar masën ma të rëndë disiplinore ,ndërprerja e mardhenjës së punës, a ka mundur ti shqiptoj ndonjë masë tjetër, e cila do ti përgjigjet shkeljeve të bëra siç janë: 1.4. ndalesën në pagë mbi 20% deri ne 30%, e pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj dhe ndonjërin nga masat plotësuese siç janë: Transfer administrativ, Trajnim obligative, Këshillim mjekësor/psikologjik dhe ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri në 1 vit.

ç) paditësi është liruar nga përgjegjësia penale, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Nga aktvendimi i datës 22.04.2024, ndaj tani paditësit , kanë pushuar hetimet, sepse nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit- tani paditësit, nuk qëndrojnë elementet e veprës penale, e cila i është vë në barrë tani paditësit.

d) E paditura nga veprimet e paditësit, nuk ka pësuar damë, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, edhe gjatë tërë procedurës, nuk është vërtetuar, se e paditura ka pësuar damë nga veprimet e paditësit. Po ashtu pala e paditur me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se e paditura ka pësuar damë, nga veprimet e paditësit.

dh) Pala paditëse, për shkak të veprimeve të paditurës (ndërprerje e mardhenjës së punës), ka pësuar damë, sepse nuk i janë paguar të ardhurat personale nga data 25.05.2023, e deri më tani. Ky damë i është shkaktuar për shkak të veprimeve të kundërligjshme të paditurës, e cila ja ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit në kundërshtim me Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019, për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore në Policinë e Kosovës dhe Ligjin e Punës.

Ndërsa sa i përket vlerës së dëmit, kjo shumë është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit financiarë, i cili ka konstatuar se shuma, e cila duhet të paguhet paditësit, është në shumë prej 11,854.33€. Gjykata vendimin, për këtë pjesë të kërkesëpadisë, e ka bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar të V.I, i cili në ekspertizës financiare, ka konstatuar se shuma e pagave të papaguara, e kontributeve pensionale dhe tatimeve në page është në shumë prej 11,854.33€. Kësaj ekspertize, gjykata ia fali besimin, sepse e njëjta është punuar në mënyrë profesionale dhe nuk është kontestuar nga palët ndërgjyqëse.

Këtë kërkesë gjykata e ka miratuar, duke u bazuar në neni 80 të Ligjit të punës, me të cilën dispozitë është paraparë: Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërin prej këtyre dëmshpërblimeve: pika 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose pika 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe

urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. Në paragrafin 2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura padisë, përgjigjen në padi, parashtrave të dorëzuara nga palët ndërgjyqëse, ekspertizës financiare dhe provave të tjera, kërkesëpadinë e paditësit e miratoj në tërësi të bazuar dhe i anuloi, vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor, me numër 110/KBD/23, i datës 17.03.2023 dhe Vendimin e Komisionit të Ankesave, i Policisë së Kosovës, me numër 199-KA-2023, si të kundërligjshme.

Këto vendime janë të kundërligjshme, sepse baza e kërkesës, është e mbështetur në faktet siç janë parashtruara në padi, janë të mbështetur në Ligjin për Policinë, Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2019, për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në policinë e Kosovës. E paditura në këtë çështje juridiko kontestimore, gjithë hetimin e saj dhe vendimet e marra ndaj tani paditësit për Ndërprerjen e Marrëdhënies së punës, nga Policia e Kosovës, i ka marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore, për faktin se në asnjë moment dhe në asnjërin nga pjesët e arsytimit të vendimit, nuk ka arritur të dëshmojë se paditësi N.L, ka kryer dhe është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 20-Sjellja e rëndë diskredituese, pika 1.14 dhe pika 1.8, neni 23-Korrupsioni dhe konflikti i interesit, nenin 24-Shkelja e rëndë e autorizimit pika 1.4 dhe pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019.

Nga provat (përgjimet), DHBVK-ja, e as KBD-ja, nuk kanë arritur që ti argumentojnë shkeljet, për të cilat e kanë shpallur përgjegjës Paditësin, për faktin se me asnjërin nga provat, nuk është argumentuar se Paditësi me veprimet dhe sjelljet e tij ,mund ta ketë dëmtuar imazhin e Policisë së Kosovës gjatë kryerjes së detyrës apo jashtë saj.

Po ashtu e Paditura, nuk ka arritur të dëshmojë, se tani këtu Paditësi, në këtë çështje Civile-juridike ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar në njërin nga paragrafët e nenit 23-Korrupsioni dhe konflikti i interesit, për faktin se nuk është arritur të dëshmohet me asnjë provë të vetme se Paditësi N.L, e ka keqpërdorur pozitën e tij si punonjës i Policisë së Kosovës, për leverdi private për vete ose për të tjerët.

Po ashtu nuk është arritur të dëshmohet, se ka kryer ndonjërin nga shkeljet e rënda disiplinore, të përcaktuara në nenin 24-Shkelja e rëndë e autorizimit, për arsye se në këtë çështje

juridiko kontestimore, nuk është arritur të argumentohet, se cilën veprë penale apo informacion të rëndësishëm, për zbulimin e veprave penale apo kryerësve të tyre, tani këtu paditësi nuk i ka raportuar tek mbikëqyrësit e tij.

E Paditura, në vendimet e saj të atakuar, me këtë padi dhe propozim, ka dështuar të vërtetojë faktet, se në cilën rrethanë paditësi ka kryer shkelje të nenit 24, pika 1.6 të U.A 04/2019 për faktin se në asnjë rrethanë nuk është arritur të argumentohet se në çfarë mënyrë, kur, si, pse, me kënd, Paditësi ka keqpërdor autoritetin e Policisë, cili ka qenë përfitimi personal apo financiar, apo se çfarë përfitime e privilegje i ka përfituar, e të cilat nuk mund t'i kenë në dispozicion, përveç kur kryejnë detyrat e tyre ose për shmangie nga pasojat e veprave kundërligjore, përveç në ato raste kur kërkohet prej tyre në mënyrë legjitime ta përdorin ndikimin apo autoritetin e tyre.

E paditura, me vendimet e saj të atakuar me padi, ka shkelur edhe dispozitën ligjore nga neni 4 par. 1 nënë par. 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-021, për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku përcaktohet se “1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji” dhe “1.2. Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme

Gjykata e ka detyruar të paditurën, që paditësin ta kthej në vendin e punës ku ka punuar më parë, sepse vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor, me numër 110/KBD/23, i datës 17.03.2023 dhe Vendimin e Komisionit të Ankesave, i Policisë së Kosovës, me numër 199-KA-2023, për shqiptimin e masave disiplinore, janë të kundërshtim me dispozitat ligjore të parapara me Udhëzimin Administrativ, Ligjin e Policisë dhe Ligjin e Punës.

Pastaj e paditura, paditësit, nuk i ka shqiptuar masën adekuate, në proporcion me shkeljet e bëra, por i ka shqiptuar masën më të rëndë e paraparë me nenin 41 Udhëzimi Administrativ

Nr. 04/2019, Masat për shkelje të rënda disiplinore për punonjësit e PK-së, duke ja shqiptuar Masën ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Pastaj gjykata me rastin e vendosjes, ka aplikuar nenin 49, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, "E drejta e Punës është e garantuar për të gjithë qytetarët." Ky parim është i mbështetur edhe në nenin 31, paragrafi 1 të Kushtetutës, i cili garanton "mbrojtje të barabartë të drejtave në procedurë." Në rastin konkret, e paditura ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita kushtetuese dhe ligjore duke shkelur të drejtat e paditësit për një procedurë të drejtë dhe të ligjshme.

Gjykata e miratoi si te bazuar, kërkesëpadinë e paditësit, sa i përket pagesës së ta ardhurave personale dhe e detyroi te paditurën, që paditësit te ja paguaj shumen prej 11,854.33€, edhe atë: shumen prej 9,854.33€, (në emër të pagave të papaguara, për periudhën kohore, 25.05.2023, e deri më datën 31.08.2024), shumen prej 1,101.46€, (ne emër te vlerës për kontributet pensionale të punësuarit dhe punëdhënësit), si dhe shumën prej 628.46€, (ne emër se tatimit ne pagë).

Gjykata e detyroi të paditurën qe paditësit të ja paguaj edhe pagat për periudhën e ardhshme, pas përpilimit të ekspertizës financiare, nga data 01.09.2024, të i, a paguaj pagat, të cilat do të bëhen të kërkueshme, deri në kthimin në vendin e punës, me kamat prej 8 %, të cilat do të llogariten, nga dita e arritjes së secilës kërkesë për pagës veç e veç, duke filluar nga data 24.12.2024 (data e seancës kryesore), e deri në pagesën përfundimtare.

Gjykata sa i përket shumës se caktuar ne piken III të dispozitivit, e ka bazuar ne ekspertizën e ekspertit financiar Vehbi Imeri, i cili në ekspertizës financiare, ka konstatuar se shuma e pagave te papaguara, e kontributeve pensionale dhe tatimeve ne pagë, është ne shume prej 11,854.33€. Kësaj ekspertize gjykata ia fali besimin, sepse e njëjta është punuar ne mënyrë profesionale dhe nuk është kontestuar nga palët ndërgjyqëse.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me pagimin e te ardhurave, gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nenit 382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 8%, duke filluar nga (24.12.2024), data e seancës kryesore, e deri në pagesën përfundimtare.

Gjykata nga provat e administruara ka gjetur se vendimet e të paditurës janë të kundërligjshme, sepse pala paditëse gjatë tërë procedurës, me asnjë provë, nuk ka mundur ta vërtetoj se janë bërë shkeljet e pretenduara. Pala e paditur ka pretenduar se vendimi mbi ndërprerjen e mardhenjës së punës është i bazuar në prova, të cilat janë siguruar gjatë hetimeve të zhvilluara në procedurën penale.

Pastaj e paditura, paditësit nuk ja ka shqiptuar masën adekuate me shkeljen e bërë, por ja ka shqiptuar masën më të rëndë disiplinore ndërprerja e mardhenjës së punës, a ka mundur të ja shqiptoj njëzën nga masat e tjera të parapara me neni 41 të këtij udhëzimi administrativ.

Gjykata me rastin e vendosjes dhe aprovimit të kërkesëpadisë, është bazuar në neni Neni 29 të Ligjit për Policinë Kosovës, në kapitullin Burimet e besueshme të informative. Në paragrafin 1 është paraparë zyrtari policor do t'i pranoj dhe vlerësoj të gjitha informatat e marra nga individët anonimë që janë relevante për kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë. Në paragrafin 2. Zyrtari policor mund të krijoj marrëdhënie bashkëpunuese të besueshme me personat më qëllim që të marrë informata relevante që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë. Ndërsa në paragrafin 3. Zyrtari policor do ta mbroj besueshmërinë e marrëdhënies të tilla bashkëpunuese. Në rastin konkret tani paditësi ka krijuar mardhënje bashkëpunuese me Sh.L, dhe nga i njëjti ka marrë informata relevante që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitimime të policisë.

Se paditësi në kohën kur ka qenë zyrtar policor ka bashkëpunuar me Sh.L dhe ka marrë informacione dhe ka dhënë informacione, është vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat lëndës, të cilat janë sqaruar më lart dhe në këtë pjesë nuk do të sqarohen për të mos i përsëritur.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila me padi dhe gjate tere këtij procesi gjyqësorë, ka kërkuar që kërkesëpadinë e miratoje në tërësi si të bazuar dhe të anulohet vendimet e të paditurës, vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor, me numër 110/KBD/23, i datës 17.03.2023 dhe Vendimin e Komisionit të Ankesave, i Policisë së Kosovës, me numër 199-KA-2023, si të kundërligjshme, po ashtu ta kthej paditësin, në vendin e punës ku ka punuar më parë, si dhe të ja paguajë pagat e papaguara, me kontributet pensionale dhe tatim në paga.

Këtyre theksimeve gjykata ua fali besimin sepse, ka gjetur se tani e paditura, paditësit ja ka ndërprerë marrëdhënien e punës në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 04/2019, Ligjin e Punës dhe Ligjin mbi diskriminimi si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjykata ja fali besimin edhe pretendimeve te palës paditëse, sa i përket pagesës se pagave te papaguara edhe atë e detyroi te paditurën, qe ta paguaj vetëm shumen prej 11,854.33€, duke u bazuar në Ekspertizën Financiare te ekspertit V.I, sepse ka konstatuar sepse kjo shumë duhet paguar.

Po ashtu gjykata e ka miratuar edhe kërkesën për pagesën e pagave për periudhën e ardhshme, pas përpilimit të ekspertizës financiare, nga data 01.09.2024, të i, a paguaj pagat, të cilat do të bëhen të kërkueshme, deri në kthimin në vendin e punës, me kamat prej 8 %, të cilat do të llogariten, nga dita e arritjes së secilës kërkesë për pagës veç e veç, duke filluar nga data 24.12.2024 (data e seancës kryesore), e deri në pagesën përfundimtare.

Gjykata po ashtu i ka analizuar edhe pretendimet e te paditurës, e cila gjate kësaj procedure i ka kontestuar kërkesat e palës paditëse dhe i ka propozuar gjykatës qe kërkesat e palës paditëse sa i përket anulimit te vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor, me numër 110/KBD/23, i datës 17.03.2023 dhe Vendimin e Komisionit të Ankesave, i Policisë së Kosovës, me numër 199-KA-2023, si të kundërligjshme, kthimin ne pune dhe pagesën e te ardhurave personale ti refuzoj si te pa bazuara.

Gjykata këtyre theksimeve nuk ua fali besimin, sepse nga provat të cilat gjenden ne shkresat e lendes si dhe gjate tere procedurës është vërtetuar se e paditura, palës paditëse ja ka ndërprerë marrëdhënien e punës ne kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 04/2019 dhe Ligjin e Punës dhe Ligjin për diskriminimi.

Gjykata e detyroi palën paditëse qe ta paguaj shumen prej 100.00€ ne emër te taksës gjyqësore për padi, këtë shume ka detyrim qe ta paguaj duke u bazuar ne kërkesën financiare, e cila pagese do te behet ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit ne dorëzim te këtij aktgjykimi, sepse për kërkesat materiale paguhet taksa gjyqësore.

Gjykata e detyroi palën e paditure qe paditësit, te ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, ne shume te përgjithshme prej 935€, edhe atë: shumen prej 78.00€ për përpilimin e padisë, shumen prej 250.00€, për ekspertizën e ekspertit financiar, si dhe shumen prej 507,00€

për 5 seanca gjyqësore të përfaqësuara nga avokati si dhe shumen prej 100.00€ në emër të taksës gjyqësore për padi.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.2024:148369 prej datës 24/12/2024

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Dërguar me datën: 09/01/2025

Te autorizuarit të paditësit 1 x 1

Te autorizuarit të paditurës 1 x 1